


Njohuritë e të rinjve të gjimnazeve mbi shëndetin seksual dhe riprodhues

Raport





Autor: © Shoqata “Together for Life”

Shoqata “Together for Life”

Rr. Brigada VIII,

Pallati jeshil tekno-projekt,

Shk. 2, Ap. 13,

Tiranë-Albania

E-mail: info@togetherforlife.org.al

Web: www.togetherforlife.org.al

Hartoi raportin:

Arlinda Shehu

Mbledhja e të dhënave:

Blertina Koka

Denisa Celami

Ky publikim është përgatitur nga shoqata “Together for Life”, mbështetur nga “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve”, me fondet e UNFPA-së.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e shoqatës "Together for Life". Opinionet e shprehura janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet ODFR-së apo UNFPA-së.

Hyrje

Shëndeti i mirë seksual dhe riprodhues është një gjendje mirëqenieje e plotë fizike, mendore dhe sociale në të gjitha çështjet që lidhen me sistemin riprodhues. Kjo nënkupton që njerëzit janë në gjendje të kenë një jetë seksuale të kënaqshme dhe të sigurt, aftësinë për të riprodhuar e pasur fëmijë dhe lirinë për të vendosur nëse, kur dhe sa shpesh ta bëjnë këtë.

Për të ruajtur shëndetin seksual dhe riprodhues, njerëzit kanë nevojë për kenë informacione të sakta dhe metoda kontraceptive të sigurta, efektive, të përballueshme dhe të pranueshme sipas zgjedhjes që bëjnë vetë. Ata duhet të informohen dhe të fuqizohen për të mbrojtur veten nga infeksionet e transmetuara seksualisht¹.

Shoqëria civile ka një rol të rëndësishëm në rritjen e informacionit për shëndetin seksual dhe riprodhues. Por është po kaq e rëndësishme të dihet se nga duhet të fillohet dhe se cila është situata e punës së kryer deri më tani.

Për këtë arsye shoqata “Together for Life” realizoi gjatë vjeshtës së vitit 2019 pyetësorë me 100 të rinj në gjimnazet e Lushnjës dhe Kukës, ndërsa gjatë vjeshtës 2020 pyetësorë me 100 të rinj në gjimnazet e Tiranës. Më poshtë është një krahasim i përgjigjeve të të rinjve në rrethe dhe në kryeqytet. Ky krahasim na bën të mundur të kuptojmë se ku kemi arritur me punën tonë të deritanishme më mirë dhe se ku duhet të fokusohemi në punën tonë kur flitet për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe të rinjtë.

Shpresojmë që gjetjet dhe rekomandimet do të jenë një ndihmë për fuqizimin e njohurive të të rinjve dhe edukimin e duhur të tyre për një jetë më cilësore në të ardhmen.

¹ <https://albania.unfpa.org/sq/topics/sh%C3%ABndeti-seksual-dhe-riprodhues>

Krahasimi i gjetjeve në rrethe dhe në Tiranë


Shoqata “Together for Life” realizoi gjatë 2019-s një pyetësor për shëndetin seksual dhe riprodhues me të rinj të gjimnazeve të Lushnjës dhe Kukësit. Nga 100 pyetësorë të plotësuar, 99 prej tyre ishin të vlefshëm, përkatësisht të ndarë në gjini 34 djem dhe 65 vajza.

Ndërkohë gjatë 2020-s u realizuan intervista me 103 të rinj nga gjimnazet në Tiranë (33 djem dhe 70 vajza).


Pyetësori i plotësuar në rrethe ishte një komunikim i drejtpërdrejtë me të rinjtë, ndërkohë që pyetësori me të rinjtë e Tiranës u përcoll online midis të rinjve. Besojmë se kjo solli një lirshmëri më të madhe tek të rinjtë për të qenë më të hapur në përgjigjet e tyre dhe kjo u vu re sidomos në faktin që tek të rinjtë në Tiranë nuk ka pyetje të paplotësuara, teksa në rrethe ka shumë të rinj që preferojnë t’i anashkalojnë përgjigjet.

Në vijim është bërë një krahasim midis përgjigjeve të dhëna nga të rinjtë në rrethet Lushnjë dhe Kukës dhe të rinjtë e gjimnazeve të kryeqytetit.


Marrë parasysh kampionin e studimit, krahasimi është bërë midis rretheve dhe Tiranës, pa i ndarë rrethet veç e veç për të ulur sa më shumë marzhin e gabimit. Gjithsesi, besojmë se studime të tilla janë të rëndësishme të jenë të herëpashershme për të parë edhe ndryshimin e perceptimit të shëndetit seksual dhe riprodhues tek brezat e ndryshëm.



Në krahasimet midis të rinjve në rrethe dhe në Tiranë rezulton se shkolla luan një rol të rëndësishëm në edukimin për shëndetin seksual dhe riprodhues, pubertetin si dhe barazinë gjinore. Gjithsesi, dallohet se në rrethe, shkolla ka një ndikim më të madh në rolin e saj edukues krahasuar me Tiranën, sidomos në çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.




Të rinjtë që morën pjesë në këtë vëzhgim u pyetën lidhur me sasinë e orëve që kanë në shkollë për shëndetin seksual dhe riprodhues. Bie në sy fakti se në rrethe dy të tretat e të rinjve deklarojnë se orët janë të mjaftueshme, krahasuar me të rinjtë në Tiranë, ku po e njëjta përqindje deklaroi se duhet të ketë më shumë orë mësimi për shëndetin seksual dhe riprodhues.



Burimet e informacionit ndryshojnë në Tiranë krahasuar me në rrethe. Një gjetje e rëndësishme është fakti që në rrethe shkolla është burim informacioni për më shumë se katër të pestat e gjimnazistëve të pyetur, ndërkohë që në Tiranë më pak se gjysma e konsiderojnë burim informacioni.

Nga ana tjetër, interneti përbën burim informacioni për më shumë se tre të pestat e gjimnazistëve në Tiranë.

Kryeqyteti ndryshon nga rrethet edhe në komunikimin brenda familjes. Nëse përmendim tre burimet kryesore të informacionit për rrethet, prindi-nënë përbën të tretën, ndërkohë që në Tiranë, burim i tretë informacioni janë shokët dhe shoqet, të konsideruara të tillë nga një në tre gjimnazistë. Kurse, lidhur me prindër, në kryeqytet më pak se një në pesë gjimnazistë komunikon me prindin-nënë dhe më pak se një në njëzet gjimnazistë komunikon me prindin-baba, duke treguar komunikimin shumë të ulët të gjimnazistëve në familje lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues. Vetëm dy nga djemtë e pyetur në Tiranë i kanë identifikuar prindërit (nënë dhe babanë) si burim informacioni për shëndetin seksual dhe riprodhues.




Të pyetur se nga do të donin ta merrnin informacionin për shëndetin seksual dhe riprodhues rezulton se në përqindje të konsiderueshme si në rrethe, ashtu edhe në Tiranë, të rinjtë vlerësojnë si burim informacioni shkollën, me Tiranën në përqindje më të lartë se në rrethe. Nga ana tjetër, lidhja e familjes dhe ndikimi i saj duket më i fortë në rrethe, ku 20% e të rinjve deklarojnë se do të donin që nëna të ishte burim informacioni për shëndetin seksual dhe riprodhues, krahasuar me të rinjtë në Tiranë që vetëm 3% e shohin nënën si burim informacioni. Gjithashtu, të rinjtë në Tiranë vetëm në një rast citojnë se do ta donin babain si burim informacioni, ndërkohë, në rrethe babai dëshirohet si burim informacioni nga 8% e të rinjve, ku shumica janë vajza.



Duke qenë se kjo pyetje është lënë e hapur për të rinjtë, vihet re se dëshira për të marrë informacion nga shkolla shoqërohet edhe me deklaratat e tilla si:

- *Të ketë mësues të përhershëm, jo mësues të përkohshëm*
- *Të jepet informacioni nga ekspertë të fushës*
- *Të ketë orë mësimorë që i kushtohen tërësisht shëndetit seksual dhe riprodhues*

Ndërkohë, vihet re se numri i të rinjve që me dëshirë do ta merrnin informacionin nga internet është tepër i ulët si në rrethe edhe në Tiranë. Gjëja që theksohet kur flitet për internetin është se kërkohet *informacion nga faqe të licencuara dhe jo nga faqe fake*.




Ndërkohë, lidhur me çështjet e pubertetit dhe barazisë gjinore vihet re se rritet ndikimi i prindit-nënë edhe në Tiranë duke u kthyer, ashtu si në rrethe, në një nga tre burimet e informacionit. Gjithsesi, në Tiranë vihet re se interneti ka gjithnjë një ndikim më të madh sesa familja, pavarësisht se në rastin e barazisë gjinore një në tre gjimnazistë deklarojnë mamanë si burim informacioni.




Mungesa e komunikimit prindër-fëmijë vihet re sidomos në pyetjen “A flisni me prindërit për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues?” Rezulton se një në tre gjimnazistë në Tiranë dhe një

në katër gjimnazistë në rrethet e përfshira në studim, nuk komunikojnë kurrë me prindërit për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues. Ndërkohë, dy në tre gjimnazistë në rrethe dhe një në dy gjimnazistë në Tiranë komunikojnë rrallë dhe vetëm një në dhjetë gjimnazistë në rreth dhe Tiranë komunikojnë shpesh me prindërit për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.



Frekuenca e komunikimit në familje për shëndetin seksual dhe riprodhues është ndarë edhe sipas gjinisë në rrethe dhe në Tiranë. Gjithsesi, vlerat e mëposhtme mund të merren me pak rezerva për shkak të kampionit të ulët të djemve (35). Për vajzat, kampioni është më afër realitetit dhe nga tabela shihet edhe se dallimi në rrethe dhe në Tiranë është shumë i vogël.




Një pyetje e cila synon të shohë se si funksionon shërbimit shëndetësor ishte edhe ajo se ku e kanë kryer vizitën e fundit mjekësore të rinjtë e gjimnazeve në rrethe dhe në Tiranë.


Rezultoni se të rinjtë në rrethe kryejnë më shumë vizitat në klinikë private dhe më pak në qendrën shëndetësore. Ajo çka bie në sy është përqindja e lartë e vizitave të kryera në spitalin publik.

Ndërkohë për Tiranën, më shumë se dy në pesë gjimnazistë tregojnë se i kryejnë vizitat në qendër shëndetësore.


Rezultatet e marra mund të interpretohen me faktin se në kryeqytet sistemi i referimit funksionon më mirë sesa në rrethe, si dhe fakti që në rrethe qendra shëndetësore anashkalohet edhe për shkak të mungesës së specialiteteve dhe kalohet direkt në spitalin publik. (Nuk është bërë krahasim me spitalet private, marrë parasysh se këto nuk ekzistojnë në Lushnjë dhe Kukës).




Të rinjtë u pyetën nëse kishin parë postera në vizitat e kryera në institucionet shëndetësore. Shihet se të rinjtë në Tiranë kanë parë më shumë postera të shëndetit seksual dhe riprodhues krahasuar me të rinjtë në rrethe. Kjo mund të lidhet me drojën, por edhe me mungesën e këtyre posterave në qendrat shëndetësore, klinikat apo spitalet që ata kanë vizituar.




Të rinjtë u pyetën edhe për sjelljen e tyre kur vizitojnë institucionet shëndetësore. Të rinjtë në Tiranë duken më aktivë në marrjen e informacionit për shëndetin seksual dhe riprodhues. Kështu një në pesë të rinj në rrethe dhe një në tre të rinj në Tiranë janë angazuar për të marrë broshurë të shëndetit seksual dhe riprodhues në institucionet shëndetësore.




Një pyetje e rëndësishme ishte lidhur me ndjesinë e krijuar në bisedën me mjekun për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues, duke qenë se mënyra e komunikimit është shumë e rëndësishme për të rinjtë. Rezulton se në Tiranë të rinjtë janë ndier më komod në bisedë krahasuar me të rinjtë në rrethe. Kështu vetëm një në pesë të rinj në rrethe është ndier komod krahasuar me një në dy të rinj në Tiranë. Ndërkohë, katër në pesë të rinj në rrethe u shprehën se nuk janë ndier të lirshëm ose janë ndier në siklet në bisedat me mjekun.




Të ndarë sipas gjinisë shihet se vajzat në rrethe në përqindje të konsiderueshme janë ndier në siklet në komunikimin me mjekun. Kjo përqindje e lartë mund të lidhet edhe me mungesën e mjekëve specialistë, sidomos ata të shëndetit seksual dhe riprodhues. Gjithsesi, besojmë se një gjë e tillë është mirë të merret dhe të thellohet më tej nga studime të tjera.




Një pyetje e rëndësishme për të rinjtë ishte edhe besimi tek mjekët për ruajtjen e privatësisë së bisedës. Rezultoi se tek të rinjtë e pyetur në rrethe, besimi është më i ulët sesa tek të rinjtë e pyetur në Tiranë. Megjithatë, në këtë rast është për t'u theksuar se më shumë se gjysma e të rinjve si në rrethe, ashtu edhe në Tiranë janë kanë asnjë opinion lidhur me faktin nëse mjeku e ruan apo jo privatësinë e bisedës.




Edhe pyetja në vijim ka një përqindje problematike që shprehet me përgjigjen “nuk e di” kur pyeten nëse morën informacionin e nevojshëm nga mjeku. Një në tre të rinj në Tiranë dhe më shumë se një në tre të rinj në rrethe shprehen se nuk kanë dijeni nëse informacioni i marrë ishte informacioni i duhur apo jo. Gjithashtu, një dallim midis Tiranës dhe rretheve qëndron në faktin se të rinjtë e përgjigjur në kryeqytet kanë një përqindje shumë më të lartë besimi se nuk kanë marrë informacionin e duhur. Kështu, një në pesë të rinj në rrethe dhe një në tre të rinj në Tiranë mendojnë që nuk kanë marrë informacionin e nevojshëm nga mjeku përkatës.




Kur u pyetën se çfarë kuptonin me termin shëndet riprodhues, rezulton se në Tiranë më shumë se në rrethe shëndeti riprodhues lidhet direct me shëndetin fizik. Kështu, më shumë se një në pesë gjimnazistë në Tiranë që iu përgjigjën pyetësorin thonë se me shëndet riprodhues nënkuptohet mirëqenia fizike. Një përqindje shumë e vogël e kanë lidhur shëndetin riprodhues me mirëqenien mendore apo sociale.




Të rinjtë u pyetën edhe lidhur me ndikimin e duhanit në shëndetin riprodhues. Rezultojnë pak a shumë të njëjtat përgjigje në nivelin e përgjigjes “shumë” me gjysmat e të rinjve që japin këtë përgjigje. Ndërkohë një në katër të rinj në Tiranë dhe një në shtatë të rinj në rrethe mendojnë se duhanpirja ka ndikim të ulët tek shëndeti riprodhues. Ajo çka vlerësohet shqetësuese është se një në katër të rinj si në Tiranë, edhe në rrethe nuk e dinë fare nëse duhanpirja ndikon apo jo në shëndetin riprodhues.




Një pyetje tepër e rëndësishme dhe që tregon lidhur me njohuritë e të rinjve është njohja e termit kontracepsion. Në rrethe një në pesë të rinj janë përgjigjur që nuk e kuptojnë fare një term të tillë. Besojmë se edhe në Tiranë situata duhet të jetë pak a shumë e njëjtë, marrë parasysh se një në shtatë të rinj është përgjigjur që kontracepsioni nuk është as e drejtë dhe as përgjegjësi.




Të rinjtë e gjmnazeve u pyetën edhe lidhur me metodat kontraceptive. Rezulton shqetësues fakti se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve si në Tiranë ashtu edhe në rrethe mendojnë se metodat kontraceptive janë vetëm për vajzat, ose nuk kanë dijeni lidhur me metodat kontraceptive. Një gjë e tillë është kuptuar sidomos në takimet me të rinjtë, ku termi “kontracepsion” apo “metoda kontraceptive” rezulton i pakuptueshëm prej tyre.



Lidhur me këtë pyetje është vlerësuar që të bëhet edhe ndarja sipas gjinisë për të kuptuar njohuritë përkatëse për djemtë dhe për vajzat. Rezulton se shifrat ndryshojnë më shumë në gjininë femërore sesa atë mashkullore kur bëhet krahasimi midis rretheve dhe Tiranës. Shqetësuese është si përqindja që përgjigjet se metodat kontraceptive janë vetëm për vajzat, ku në Tiranë kjo përqindje është e lartë, ashtu edhe përqindja e lartë që nuk kanë dijeni lidhur me këtë çështje, ku më e ulëta arrin në 26% në vajzat që iu përgjigjën pyetësorit në kryeqytet, çka nënkupton që të paktën një në katër të rinj nuk e kanë idenë nëse metodat kontraceptive janë vetëm për vajzat apo jo. Nisur nga bisedat me të rinjtë, dyshohet se përgjigjja nuk e di lidhet në një përqindje të konsiderueshme edhe me moskuptueshmërinë e termimit “metoda kontraceptive”.




Për të kuptuar më shumë për shëndetin seksual dhe riprodhues të rinjtë u pyetën edhe për HIV/Aids. Rezulton se mbi 90% e të rinjve kanë dijeni për faktin se HIV është një virus seksualisht i transmetueshëm që sulmon sistemin imunitar. Një përqindje e vogël përgjigjen që nuk e dinë se çfarë është HIV-i dhe po kështu një përqindje e vogël thonë se HIV është sëmundje.




Shqetësues është mendimi i të rinjve se një person i prekur nga HIV/Aids dallohet që në pamje të jashtme. Kjo përqindje është më e lartë në rrethe, ku gati gjysma e të rinjve që iu përgjigjën pyetësorit mendojnë se mund ta dallojnë një të prekur me HIV/Aids që në pamje krahasuar me një në pesë të rinj që iu përgjigjën pyetësorit në Tiranë.

Ndërkohë, e lartë është edhe përqindja e të rinjve që nuk dinë t'i japin përgjigje kësaj pyetjeje, ku në rrethe arrin në një në katër të rinj që kanë marrë pjesë në këtë pyetësor krahasuar me Tiranën, që është një në shtatë të rinj.



Dallime mes rretheve dhe Tiranës ka edhe në përgjigjet e pyetjes se cilat sjellje përbëjnë rrezik për infektimin me HIV/Aids. Gati gjysma e të rinjve në Tiranë thonë se marrëdhëniet seksuale të pambrojtura përbëjnë rrezik përkundrajt çerekut të të rinjve në rrethe.

Ndërkohë, përgjigjen në mënyrë pothuajse të barabartë për rrezikun që ka shkëmbimi i shiringave dhe përdorimi i drogës në infektimin me HIV/Aids. Nga ana tjetër, është më i lartë në rrethe perceptimi që të gjitha sjelljet e mësipërme përbëjnë rrezik për infektimin me HIV/Aids.



Pyetje të tjera që iu bënë të rinjve lidheshin edhe me njohuritë e tyre për infeksionet seksualisht të transmetueshme, gjithsesi përqindja e përgjigjeve nuk kishte vlerë krahasuese.

Përfundime

Shëndeti seksual dhe riprodhues është shumë i rëndësishëm në jetën e çdo njeriu dhe përkujdesja nis që në fëmijërinë e hershme. Në kulturën shqiptare të folurit për shëndetin seksual dhe riprodhues ka qenë një tabu dhe shumë shpesh bisedat janë anashkaluar edhe në lidhjen direkte nënë-fëmijë. Hyrja në adoleshencë e vajzave dhe e djemve nuk është e këndshme, sidomos nëse kjo hyrje e bën individin konfuz për shkak të mungesës së njohurive për çfarë po ndodh me trupin e tyre. Nga vëzhgimet e mësipërme rezulton se:

1. Komunikimi për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues vijon të mbetet problematik për të rinjtë që ndjekin gjimnazet.

Vihet re një rol shumë i ulët i familjes në ofrimin e një informacioni të saktë e të sigurtë dhe fatkeqësisht rezulton se në Tiranë roli i familjes është akoma më i ulët se në rrethe. Shkolla dhe interneti përbëjnë burimet kryesore për shëndetin seksual dhe riprodhues, me internetin në një rol të pazëvendësueshëm, sidomos tek të rinjtë e kryeqytetit.

2. Vihet re dëshira e të rinjve për më shumë informacion të sigurtë për shëndetin seksual dhe riprodhues. Kërkohet që ky informacion të merret në burime zyrtare, ku shkolla shihet gjerësisht si e tillë, duke kërkuar, sidomos të rinjtë e pyetur në Tiranë, shtim të orëve të mësimin me mësues të kualifikuar.
3. Ka probleme në komunikimin mes mjekut dhe gjimnazistëve për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues. Problemet që vihen re lidhen me:
 - mungesën e besimit tek mjeku për ruajtjen e privatësisë
 - mungesën e rehatisë në bisedën për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues
 - mungesën e informacionit të plotë mbi çështjet e kërkuara
 - mungesën e kuptueshmërisë së të rinjve lidhur me të drejtat e tyre si pacientë
4. Shihet një mungesë njohurish tek të rinjtë në kuptueshmërinë e termave mjekësorë, sidomos kur lidhen me kontracepsionin. Në bisedat me ta, një përqindje e konsiderueshme ende nuk e kuptojnë se çfarë është kontracepsioni me 40% të të rinjve në rrethe përkundrajt 27% të të rinjve në Tiranë që përgjigjen se nuk e dinë nëse metodat kontraceptive janë vetëm për vajzat.
5. Lidhur me sëmundjet infektive, si infeksionet seksualisht të transmetueshme, njohuritë rezultojnë të uëlta. Në një nga pyetjet kyçe lidhur me faktin nëse një person me HIV/Aids

dallohet nga pamja e jashtme, rezulton se dy në pesë të rinj në rrethe dhe një në pesë të rinj në Tiranë mendojnë se mund ta dallojnë një person me HIV/Aids që në pamje. Një perceptim i tillë, tepër i gabuar, tregon edhe rrezikshmërinë e lartë të të rinjve për infektimin me infeksione seksualisht të transmetueshme.

Rekomandime

Bazuar në gjetjet dhe përfundimet e vëzhgimit me të rinjtë në Tiranë dhe në rrethe, rekomandojmë si më poshtë:

- Rritje të informacionit të saktë dhe të sigurt online që lidhet me shëndetin seksual dhe riprodhues, marrë parasysh përbindjen e lartë të të rinjve që e përdorin internetin si burim informacioni.
- Rritje e informimit të prindërve për të përmirësuar komunikimin prind-fëmijë me qëllim rritjen e rolit të tyre në qenien burim informacioni të sigurt për shëndetin seksual dhe riprodhues për të rinjtë, një nevojë e shprehur nga të rinjtë.
- Rritje e informacionit për termat mjekësor të përdorur për shëndetin seksual dhe riprodhues.
- Rritje e rolit të shoqërisë civile për lobim në institucionet shëndetësore qendrore për rritjen e numrit të mjekëve të kualifikuar për shëndetin seksual dhe riprodhues, sidomos në rrethe.
- Nisur nga gjetjet, rekomandojmë dhënien rëndësi të çështjeve të shëndetit seksual dhe riprodhues edhe në shkolla, duke avokuar në institucionet përkatëse për të caktuar mësues të kualifikuar mbi këto tema.